



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT/ OFFICE OF THE PRIME MINISTER/ URED
PREMIJERA

AGJENCIA PER BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST
POLOVA/ AGENCY OF GENDER EQUALITY

289/06/2022
Datë:21/06/2022

RAPORT

Implementimi i thirrjes publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve të OJQ-ve që kontribuojnë në :

- 1)Hulumtimin për situatën e grave dhe vajzave në sport,përmes analizës së: buxhetit të sportit me ndjeshmëri gjinore, analizës së stereotipeve gjinore që mund të pengojnë qasjen e grave dhe vajzave në sport.
- 2)Analizën e situatës nga aspekti gjinor i pozitës së grave të dënuara për dhunën në familje duke përfshi politikën ndëshkimore për rastet e grave-dhunuese.
- 3)Realizimi i hulumtimit për përfaqësimin e grave dhe vajzave në pozitën vendimmarrëse në sektorin publik dhe privat.

Hyrje

Agjencia për Barazi Gjinore ka bërë thirrje publike me 17.05.2022 për financim të projekteve të OJQ-ve në zbatim të drejtpërdrejtë të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore dhe Planit të Veprimit 2020-2024, respektivisht analizave gjinore dhe hulumtimeve që analizojnë gjendjen e grave dhe burrave sipas objektivave Strategjike

Shtylla II: Zhvillimi Njerëzor, Rolet dhe Marrëdhëniet Gjinore

Shtylla III: Te drejtat e grave ,qasja në drejtësi dhe siguria.

Agjencia për Barazi Gjinore ka realizuar këtë thirrje publike duke respektuar standardet me të larta të konkurrencës, transparencës dhe vendim marrjes në përputhje me rregulloren MF-Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Në kuadër të kësaj thirrje publike Agjencia për Barazi Gjinore ka pranuar aplikimet e gjithsej 12 Organizata Jo Qeveritare të cilat kanë paraqitur projektet e tyre për mbështetje financiare. Ne vijim është paraqitur lista e të gjithë aplikantëve (OJQ-ve) që kanë aplikuar në kuadër të kësaj thirrje publike.

1. OJQ - SIT
2. OJQ - CZA
3. OJQ- YOUTH RIGHTS
4. OJQ-IN TIME
5. INSTITUTI I KOSOVES PER REND DHE LIGJ
6. OJQ ZANA
7. OJQ -DEMO SPORT
8. OJQ -ALTERNATIVA RINORE
9. OJQ -INICIATIVA RINORE
10. QENDRA KOSOVARE PER SIGURI -QKSS
11. QENDRA PER HUMUMTIM EKONIMIKE ZHILLIM DHE EDUKIM
12. INSTITUTI RIINVEST

Vlerësimi

Agjencia për Barazi Gjinore ka themeluar Komisionin vlerësues me nr të vendimit 268/2022 i përberë nga 3 zyrtar të ABGJ-së dhe dy anëtar/e përfaqësues nga Shoqëria Civile gjegjësisht ekspert të jashtëm i cili kishte për detyrë të vlerësoj te gjitha aplikacionet e paraqitura në kuadër te thirrjes publike.

Komisioni Vlerësues i themeluar sipas thirrjes dhe në përputhje me kërkesat e Rregullores MF-Nr. 04/2017, ka bërë hapjen dhe vlerësimin e çdo aplikacioni, nëse ato i plotësojnë kriteret formale duke përfshirë kriteret për kualifikim të aplikantëve për mbështetje publike financiare sipas neneve 10 dhe 11 të rregullores

Komisioni ka vlerësuar se që të 12 OJQ aplikuese nuk i kanë plotësuar në tërësi kriteret e parapara me nenin 10 dhe 11 të Rregullores dhe kriteret e thirrjes publike andaj sipas nenit 17 paragrafit 2 të njejtat nuk kalojnë fare në fazën e vlerësimit përmbajtësor dhe si të tilla diskualifikohen .

Bazuar në vlerësimin e lartëshënuar Komisioni rekomandon që ABGJ-ja të bëjë rishpalljen e thirrjes publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve të OJQ-ve

Anetarët e Komisioni

Adelina Kajtazi-Kryesues

Refiqe Murtezi-Anëtare

Shqipe Arifaj-Anëtare

Leonora Selmani-Anëtare

Rexhep Gojnovci-Anëtar

